



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

VENDIM

Nr.645, datë 23.12.2020

PËR

**MIRATIMIN E “PROGRAMI I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË
GJYQTARËVE PËR VITIN 2021”**

Këshilli i Lartë Gjyqësor bazuar në nenin 147 pika 1 shkronja “a” të Kushtetutës, në nenet 2, 68-72, 74-78, 84-95, 97 dhe 171 të Ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, në vendimet e KLGJ-së nr. 263 datë 21.11.2019 “Rregullat plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” dhe nr. 264 datë 21.11.2019, “Metodologjia e pikëzimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit të gjyqtarit”, me propozimin e Komisionit të Vlerësimit të Etikës dhe Veprimtarisë Profesionale,

VENDOSI:

1. Miratimin e “Programi i vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2021”, sipas tekstit që i bashkëlidhet këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi në datën e publikimit në faqen zyrtare të Këshillit.

PËR KËSHILLIN E LARTË GJYQËSOR

KËSHILLI I LARTË GJYQËSOR

PROGRAM

I VLERËSIMIT ETIK DHE PROFESIONAL TË GJYQTARËVE PËR VITIN 2021

Këshilli i Lartë Gjyqësor (në vijim KLGJ), bazuar në 85/1 të ligjit nr.96/2016 “Për statusin e gjyqtarëve dhe të prokurorëve në Republikën e Shqipërisë” i ndryshuar, brenda muajit nëntor të çdo viti, duhet të miratojë programin me listën e gjyqtarëve dhe kryetarëve të gjykatave, për të cilët do të kryhet vlerësimi etik dhe profesional përgjatë vitit pasardhës, bashkë me përcaktimin e periudhës së vlerësimit.

Qëllimi i këtij programi është përgatitja paraprakisht e një plani pune me emrat e gjyqtarëve që do të vlerësohen përgjatë vitit 2021, por nuk nënkupton fillimin e procesit të vlerësimit. Miratimi i këtij programi iu shërben gjithashtu Kryetarëve e Kancelarëve të gjykatave, që të organizojnë punën për plotësimin e tabelave statistikore e dërgimin e tyre në KLGJ, brenda muajit janar, para se të fillojë procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar të përfshirë në këtë listë.

Skema e Vlerësimit Etik dhe Profesional të Gjyqtarëve është plotësuar tashmë me të gjithë aktet nënligjore dhe është tërësisht e zbatueshme për gjyqtarët në detyrë. Veç tyre, mbeten ende prioritete për Këshillin, miratimi i rregullave plotësuese të skemës së vlerësimit për ndihmësmagjistratët në Gjykatën e Lartë, gjyqtarët e komanduar në KLGJ si dhe kryetarët e gjykatave.

Projekt-programi i vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021 është konceptuar i ndarë në 4/pjesë, si më poshtë :

I. Gjendja e procedurave të vlerësimit të filluara gjatë vitit 2020, sipas programit të miratuar për këtë vit.

Me vendimin nr. 276, datë 10.12.2019, Këshilli i Lartë Gjyqësor ka miratuar “Programin e vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve për vitin 2020”, duke përcaktuar tri kategori vlerësimesh për vitin 2020 :

- 1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë nga organet e rivlerësimit, në vijim të procesit të vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, e cila përkon me periudhën 3/vjeçare të rivlerësimit kalimtar;
- 2) Vlerësimin normal të gjyqtarëve me jo më pak se 3/vjet dhe jo më shumë se 15/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2017, për periudhën e vlerësimit 2017-2019.
- 3) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2019-31.12.2019, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Deri në miratimin e programit të vitit 2020, në kategorinë sipas pikës 1, përfshiheshin 15 gjyqtarë, për të cilët, pas dërgimit të dosjeve nga organet e rivlerësimit kalimtar, ka filluar dhe është në proces procedura e vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016. Përveç gjyqtarëve

të përfshirë në këtë listë, procedura e vlerësimit për periudhën e vlerësimit 2013-2016, ka filluar edhe për 12 gjyqtarë të tjerë, për të cilët vendimi i organeve të rivlerësimit ka marrë formë të prerë gjatë vitit 2020. Konkretisht procedura e vlerësimit për këtë periudhë ka filluar në total për 27 gjyqtarë sipas vendimeve të Këshillit me nr.198, datë 11.06.2020, nr. 233, datë 02.07.2020 dhe nr. 336, datë 24.9.2020 dhe atij Nr. 645, datë 23.12.2020. Ecuria e kësaj procedure vlerësimi është e ndërvarur jo vetëm nga marrja formë të prerë e vendimit të konfirmimit në detyrë, por edhe nga dërgimi i dosjeve me aktet e vlerësimit profesional nga organet e rivlerësimit kalimtar.

Në programin e vlerësimit të vitit 2020, janë përfshirë në vlerësim, për periudhën 3/vjeçare të vlerësimit 2017-2019, 106 gjyqtarë. Procedura e vlerësimit normal 3/vjeçar nuk ka filluar për asnjërin prej gjyqtarëve të përfshirë në këtë listë, për shkak të vlerësimit me prioritet nga ana e Këshillit të gjyqtarëve që kanë aplikuar për ngritje në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Posaçme, për të cilët ka filluar procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit, viti kalendarik 2019. Për periudhën e vlerësimit 2017-2019, me vendimin nr. 635, datë 16.12.2020, ka filluar vlerësimi vetëm për një gjyqtare, znj. Lutfije Celami, për shkak të aplikimit prej saj për ngritje në detyrë dhe pamundësisë objektive për të kryer për të, vlerësim të përshpejtuar të detyruar për vitin e fundit kalendarik.

Përgjatë vitit 2020, nga ana e Këshillit, me vendimet nr. 247, datë 09.07.2020, nr.314, datë 14.09.2020, nr.337, datë 24.09.2020 dhe nr. 634, datë 16.12.2020, ka filluar për 41 gjyqtarë të cilët kanë kandiduar për ngritje në detyrë, procedura e vlerësimit të përshpejtuar të detyruar, viti kalendarik 2019.

Në tërësi, në vitin 2020, kanë filluar dhe janë në proces, procedurat e vlerësimit si më poshtë:

- Vlerësim me qëllim gradimi për periudhën e vlerësimit 2013-2016 – 27 gjyqtarë;
- Vlerësim 3/vjeçar për periudhën e vlerësimit 2017-2019 – 1 gjyqtar;
- Vlerësimi i përshpejtuar i detyruar për vitin kalendarik 2019- 41 gjyqtarë.

KVEVP i ndërgjegjshëm për rëndësinë që ka realizimi në kohë i programit të vlerësimeve, ka qenë në pamundësi objektive për ta realizuar atë plotësisht, për shkak të disa faktorëve të tillë si :

- Fillimi i procedurës së vlerësimit të përshpejtuar të detyruar për vitin kalendarik 2019 për 41 gjyqtarë të cilët kandidojnë për ngritjen në detyrë në Gjykatën e Lartë, Gjykatat e Apelit dhe Gjykatat e Posaçme për Korrupsionin dhe Krimin e Organizuar, kategori e cila përbën prioritet në procedurat e vlerësimit etik dhe profesional sipas Programit të Vlerësimit të miratuar për vitin 2020 dhe neneve 22 dhe 23/b të vendimit të KLGJ nr.263, datë 21.11.2019.
- Fillimi i procedurës së vlerësimit me qëllim përcaktimin e nivelit të vlerësimit për periudhën 2013-2016 për 27 gjyqtarë, kategori e cila përbën prioritet në procedurat e vlerësimit sipas parashikimeve të nenit 171 të Ligjit për Statusin dhe nenit 23/a të vendimit nr.263, datë 21.11.2019.
- Vështirësitë e krijuara në ecurinë e procedurave të vlerësimit për shkak të situatës së pandemisë si pasojë e përhapjes së virusit Sars-Cov-2 si dhe masat e marra nga KLGJ dhe gjykatat për parandalimin e përhapjes së tij, të cilat në mënyrë të herë pas hershme kanë shkaktuar pezullimin e veprimtarisë së gjykatave, duke pamundësuar dërgimin në kohë të statistikave, zhvillimin e procedurave të shortit për përzgjedhjen e dosjeve për vlerësim, etj.
- Vështirësitë e krijuara për të plotësuar në kohë dosjet e vlerësimit për shkak të pezullimit ose reduktimit të veprimtarisë në gjykata, që ka pasjellë dërgimin me vonesë të dosjeve të përzgjedhura me short për vlerësim si dhe pritjen për kryerjen nga ILD të verifikimit të ankesave të paraqitura për gjyqtarët në proces vlerësimi, institucion që ka treguar

bashkëpunim maksimal për kryerjen me prioritet të verifikimeve të kërkuara nga ana e KLGJ.

II. Përcaktimi i listës së gjyqtarëve dhe periudhës së vlerësimit etik dhe profesional për vitin 2021.

Në zbatim të nenit 85 të Ligjit “Për statusin”, programi i vlerësimit duhet ndërtuar në mënyrë të tillë që të sigurojë vlerësimin etik dhe profesional në kohë të gjyqtarit. Objektivat për zhvillimin profesional të gjyqtarit, duhet t’i përgjigjen nevojave reale të dala nga vlerësimi i punës së tij, me qëllim që rekomandimet për përmirësim të jenë koherente dhe të mundshme për tu realizuar. Inkoherenca midis vlerësimit dhe promovimit të gjyqtarëve duhet minimizuar gjithashtu. Nga ana tjetër, vlerësimi duhet të mbulojë të gjithë përvojën profesionale të gjyqtarit.

Bazuar në parimet e mësipërme, vlerësimi periodik i gjyqtarëve, kryhet 1 herë në 3 vjet për gjyqtarët me më pak se 15 vjet përvojë profesionale dhe 1 herë në 5 vjet për gjyqtarët që kanë përvojë profesionale mbi 15 vjet. Në kushtet kur periudha e rivlerësimit kalimtar 2013-2016, për efekt të ligjit, konsiderohet periudhë vlerësimi për gjyqtarin që konfirmohet në detyrë, vlerësim që përfundon me gradimin e gjyqtarit (niveli i vlerësimit), fillimi i vitit të parë mbi të cilin duhet të llogariten periudhat e mëpasshme të vlerësimit 3 apo 5/vjeçare, është viti 2017 (01.01.2017). Në këto kushte në vitin 2021 nuk mund të kemi vlerësim etik dhe profesional 5/vjeçar, pasi kjo periudhë vlerësimi plotësohet në dt. 31.12.2021 dhe duhet të fillojë në vitin 2022. Prandaj programi i vlerësimeve të vitit 2021 do të përfshijë përsëri një periudhë 3/vjeçare vlerësimi. Kjo periudhë vlerësimi përkon me periudhën kalendarike 01.01.2017-31.12.2019 dhe 01.01.2018-31.12.2020, meqë periudha e vlerësimit përfshin jo vetëm atë vit që ka përfunduar, por edhe atë që përfundon në vitin përkatës në të cilin miratohet programi, në këtë rast në dt. 31.12.2020.

Sa më sipër, për periudhën e vlerësimit 01.01.2017-31.12.2019, do të vlerësohen të gjithë gjyqtarët që kanë mbi 3/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2020 dhe jo më shumë se 15/vjet përvojë profesionale në dt. 01.01.2021. Nga kjo kategori do të përjashtohen edhe gjyqtarët që i plotësojnë 15/vjet përvojë profesionale përgjatë vitit 2021.

Kategoria e gjyqtarëve me më shumë se 15/vjet përvojë profesionale apo që bëhet e tillë përgjatë vitit 2021, duhet të përfshihet në programet e vlerësimit të vitit 2022 e në vazhdim, pasi të plotësohet prej tyre periudha 5/vjeçare e vlerësimit duke filluar nga 01.01.2017. Por këta gjyqtarë do të jenë subjekt të vlerësimit të përsheptuar të detyruar, në rast kandidimi për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele.

Lista me gjyqtarët që do të vlerësohen përgjatë vitit 2021, për periudhën e vlerësimit 2017-2019 përbëhet nga :

LISTA I

NR	Gjyqtar	Gjykata	Fillimi i detyrës	Vite Pune
1	Adelajda Gjuzi	Gj. Rr. Berat	10.10.2012	8 vite e 2 muaj
2	Matilda Llangozi	Gj.Rr. Berat	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
3	Rudina Palloj	Gj.Rr.Berat	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
4	Edvan Velçani	Gj.Rr. Dibër	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
5	Gilda Hoxha Llambraj	Gj.Rr. Dibër	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
6	Nertila Kape	Gj. Rr. Dibër	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
7	Besjana Garxenaj	Gj.Rr. Durrës	20.11.2015	5 vite e 1 muaj

8	Nurjeta Tafa	Gj. Rr. Durrës	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
9	Paulin Çera	Gj. Rr. Durrës	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
10	Enkelejda Kapedani	Gj.Rr.Elbasan	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
11	Matilda Fetau	Gj. Rr. Elbasan	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
12	Ejona Lazellari	Gj.Rr.Fier	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
13	Matilda Shalla	Gj.Rr.Fier	05.10.2007	13 vite e 2 muaj
14	Olkeda Manellari Liçe	Gj.Rr.Fier	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
15	Arben Dosti	Gj.Rr.Gjirokastrë	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
16	Diamela Goxha	Gj. Rr. Kavajë	10.10.2012	8 vite e 2 muaj
17	Genti Dokollari	Gj. Rr. Kavajë	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
18	Flojera Davidhi	Gj.Rr.Korçë	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
19	Sonjela Voskopi	Gj.Rr.Korçë	05.10.2007	13 vite e 2 muaj
20	Engjëllushe Tahiri	Gj.Rr.Krujë	07.01.2009	11 vite
21	Aurel Arapi	Gj.Rr.Kurbin	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
21	Artan Hajredinaj	Gj.Rr.Lezhë	20.03.2007	13 vite e 9 muaj
23	Elsa Ulliri	Gj.Rr.Lezhë	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
24	Ersida Bajgora	Gj.Rr.Lushnje	20.11.2015	5 vite e 1 muaj
25	Zeta Tërpollari	Gj.Rr.Lushnje	07.01.2009	11 vite
26	Yrfet Shkreli	Gj.Rr.Përmet	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
27	Artan Jahollari	Gj.Rr.Pogradec	20.11.2015	5 vite e 1 muaj
28	Arbër Çela	Gj.Rr.Shkodër	27.09.2010	10 vite e 3 muaj
29	Besmir Stroka	Gj.Rr.Shkodër	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
30	Sokol Shehu	Gj.Rr.Shkodër	10.11.2011	9 vite e 1 muaj
31	Ahmet Metaliaj	Gj.Rr.Tiranë	08.02.1996- 25.05.1999 21.11.2016	7 vite e 4 muaj
32	Alma Kodraliu	Gj.Rr.Tiranë	07.01.2009	11 vite
33	Armela Hasantari	Gj.Rr.Tiranë	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
34	Irena Plaku	Gj.Rr.Tiranë	27.09.2010	10 vite e 3 muaj
35	Kastriot Gramshi	Gj.Rr.Tiranë	04.09.1999 27.09.2004 10.07.2014	11 vite e 5 muaj
36	Oltjona Goxha	Gj.Rr.Tiranë	20.11.2015	5 vite e 5 muaj
37	Sokol Pasho	Gj.Rr.Tiranë	08.02.1996- 19.09.2000 07.03.2016	8 vite e 6 muaj
38	Sami Ujkashi	Gj.Rr.Tropojë	21.12.2010	10 vite
39	Atalanta Zeqiraj	Gj.Rr.Vlorë	21.10.2013	7 vite e 2 muaj
40	Ervin Trashë	Gj.Rr.Vlorë	05.10.2007	13 vite e 2 muaj
41	Esmerilda Habili	Gj.Rr.Vlorë	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
42	Bib Ndreca	Gj.Posaçme e Shk.1	07.01.2009	11 vite
43	Ergys Gashi	Gj.Adm.Durrës	20.11.2015	5 vite e 1 muaj
44	Gentian Marku	Gj.Adm.Shkodër	31.10.2014	6 vite e 2 muaj
45	Enerjeta Deraj Shehaj	Gj.Adm.Tiranë	05.10.2007	13 vite e 2 muaj
46	Gentian Hamiti	Gj.Adm.Tiranë	05.10.2007	13 vite e 2 muaj
47	Semiramis Hoxholli	Gj.Adm.Tiranë	20.11.2015	5 vite e 1 muaj

48	Gentiana Xhelili	Gj.Adm.Vlorë	07.01.2009	11 vite
49	Bevis Shehaj	Gj.Adm.Vlorë	20.11.2015	5 vite e 1 muaj
50	Laurent Fuçia	Gj.Ap.Vlorë	27.09.2010	10 vite e 3 muaj
51	Dritan Hasani	Gj.Ap.Korçë	10.10.2012	8 vite e 2 muaj
52	Vojsava Osmanaj	Gj.Ap.Shkodër	05.10.2007	13 vite e 2 muaj

Në këtë listë gjyqtarësh, nuk janë përfshirë veç kategorisë së mësipërme (përvojë profesionale më shumë se 15/vjet, apo që bëhet e tillë përgjatë vitit 2021), edhe gjyqtarët që :

- 1) janë aktualisht në procedure vlerësimi të përshpejtuar të detyruar viti kalendarik 2019;
- 2) kanë qenë të komanduar si ndihmësmagjistratë në Gjykatën e Lartë gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019. Këta gjyqtarë do të vlerësohen me prioritet pas miratimit të rregullave të vlerësimit për këtë kategori, sipas një programi të veçantë që do të miratojë Këshilli;
- 3) kanë qenë të komanduar në KLGJ gjatë periudhës së vlerësimit 2017-2019. Edhe këta gjyqtarë do të vlerësohen me prioritet pas miratimit të rregullave të vlerësimit për këtë kategori, sipas një programi të veçantë që do të miratojë Këshilli;

Lidhur me periudhën e vlerësimit 2018-2020, nga lista e dërguar nga Njësia e Burimeve Njerëzore pranë KLGJ-së, konstatohet se veç gjyqtarëve të Listës I më sipër, për të cilët vitit 2020 do të përbëjë fillimin e një periudhe të re vlerësimi, nuk ka asnjë gjyqtar tjetër që plotëson së paku 3/vite përvojë profesionale në dt. 31.12.2020. Emërimi i fundit si gjyqtarë i magjistratëve të diplomuar para krijimit të KLGJ-së, përkon me datën 20.11.2015. Këta gjyqtarë janë përfshirë tek lista I. Në vitin 2016 janë emëruar 3/gjyqtarë të tjerë, të cilët edhe ata janë përfshirë tek Lista I, me përjashtim të gjyqtarit Kujtim Vraniçi, i cili ka përvojë profesionale mbi 15/vjet. Në vitin 2017 dhe vitin 2018 nuk ka gjyqtarë të emëruar. Emërimet e tjera si gjyqtarë të magjistratëve të diplomuar janë bërë pas krijimit të KLGJ-së, respektivisht në datat 30.07.2019, 29.01.2020 dhe 27.10.2020. Këta gjyqtarë të emëruar në vitin 2019 e më pas, nuk kanë plotësuar ende 3/vite përvojë profesionale për tu bërë subjekte vlerësimi.

Sa më sipër, periudha kalendarike 2018-2020 nuk mund të shërbejë si periudhë vlerësimi 3/vjeçare për asnjë gjyqtar.

Veç LISTËS I, programi i vlerësimit për vitin 2021 përmban edhe:

- 1) Gradimin e gjyqtarëve, të konfirmuar në detyrë me vendim të formës së prerë, për të cilët do të dërgohen në vijim nga organet e rivlerësimit, aktet e vlerësimit të tyre profesional. Për shkak të të njëjtit qëndrim të mbajtur edhe në programin e kaluar, gjyqtarët të cilët janë anëtarë të KLGJ-së, nuk janë përfshirë përsëri në këtë program, pasi e kundërta do t' i vendoste ata në një pozicion jo të përshtatshëm përsa i përket perceptimit të publikut dhe gjyqtarëve të tjerë. I njëjti qëndrim mbahet edhe për gjyqtarin z. Ardian Dvorani, i cili nuk ka qenë subjekt vlerësimi gjatë periudhës 2013-2016. Lidhur me fillimin e procedurave të vlerësimit me qëllim gradimi, ato do t' i propozohen për miratim Mbledhjes Plenare, menjëhere me dërgimin e dosjes së vlerësimit nga organet e rivlerësimit, sikundër është vepruar edhe përgjatë vitit 2020.
- 2) Vlerësim të përshpejtuar të detyruar për periudhën e vlerësimit 01.01.2020-31.12.2020, sipas një programi të veçantë që Këshilli do të miratojë në rastet kur kërkohet nga gjyqtari, ngritja në detyrë ose lëvizja paralele.

Pjesë e këtij programi vlerësimi, sikundër edhe në vitin paraardhës, nuk janë kryetarët e gjykatave, sepse aktualisht pjesa më e madhe e gjykatave drejtohen nga zëvendëskryetarët. Një

numër i konsiderueshëm i kryetarëve të gjykatave janë shkarkuar gjatë procesit të rivlerësimit kalimtar. Veç kësaj rrethane, rregullat plotësuese të vlerësimit të veprimtarisë së Kryetarëve nuk janë miratuar ende nga Këshilli. Përcaktimi i listës me kryetarët e gjykatave që do të vlerësohen, mbetet një nga prioritetet e ardhshme të programit të vlerësimit.

III Planifikimi 3/mujor i vlerësimeve individuale

Në lidhje me planifikimet 3/mujore të fillimit të procesit të vlerësimit, në nenin 11 pika 1 të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”, është përcaktuar se: *“Këshilli miraton brenda muajit nëntor të çdo viti, programin vjetor të vlerësimeve etike dhe profesionale. Programi vjetor përmban, për aq sa është e mundur, edhe planifikimin tremujor të vlerësimeve individuale, duke garantuar një organizim efikas të procedurave të vlerësimit si dhe lehtësimin e zhvillimit të shortit.*

Në zbatim të dispozitës së mësipërme, planifikimet 3/mujore të vlerësimeve bëhen pjesë e programit të vlerësimit, për aq sa është e mundur. Duke marrë në konsideratë faktin që ky është programi i dytë i vlerësimeve pas krijimit të KLGJ-së, situatën në të cilën ndodhen gjykatat për shkak të procesit të rivlerësimit kalimtar si dhe për shkak të pezullimit ose reduktimit të herë pas herëshëm të veprimtarisë për shkak të pandemisë, vendet vakante që mund të hapen, kërkesat për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele... etj, KLGJ vlerëson që planifikimet 3/mujore të vlerësimeve të miratohen me vendim të veçantë të Këshillit, mbi bazën e të cilit do të fillojë edhe procesi i vlerësimit për secilin gjyqtar si dhe të fillojnë në muajin Mars 2021 duke u ndarë në 3 programe të veçanta 3/mujore. Ndërkohë muajt e parë të vitit 2021 do të shërbejnë për përfundimin e procedurave të vlerësimit të filluara në vitin 2020.

IV Prioritetet e planifikimeve 3/mujore

Prioritetet e planifikimeve 3/mujore të programit të vlerësimit 2021, janë si më poshtë :

1. Kryerjen me përparësi të të gjitha vlerësimeve me procedurë të përshpejtuar të detyruar, sipas neneve 22 dhe 23/b të vendimit nr. 263, dt 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve”;
2. Gradimin e gjyqtarëve të cilët kanë kaluar me sukses procesin e rivlerësimit kalimtar me vendim të formës së prerë, bazuar kjo në nenin 23/a të vendimit nr. 263, datë 21.11.2019 “Për miratimin e rregullave plotësuese të vlerësimit etik dhe profesional të gjyqtarëve” dhe nenin 171/5 të Ligjit “Për Statusin, gradim i cili fillon menjëherë me dërgimin e dosjeve nga organet e rivlerësimit ;
3. Vlerësimin e gjyqtarëve të komanduar si ndihmësmagjistratë apo atyre të komanduar në Këshill, në rast aplikimi prej tyre për ngritje në detyrë apo lëvizje paralele;
4. Vlerësimin normal për periudhën 01 Janar 2017 – 31 Dhjetor 2019 të të gjithë gjyqtarëve të Listës I, me rend përparësie si më poshtë :
 - a) gjyqtarëve të cilët kanë mbi 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 31.12.2020, dhe që nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm. Kriteri për periudhën “mbi 7 vjet përvojë profesionale”, lidhet me kriterin e përvojës profesionale për ngritjen në detyrë në gjykatën e apelit. Ndërkohë kriteri “nuk kanë asnjë vlerësim profesional të mëparshëm” mundëson vënien, sa më shumë të jetë e mundur, në pozita të barabarta të të gjithë gjyqtarëve.
 - b) gjyqtarët të cilët kanë mbi 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 31.12.2020 dhe që kanë një vlerësim profesional të mëparshëm, me qëllim që këtyre gjyqtarëve t’iu mundësohet një vlerësim i dytë real dhe në kohë;
 - c) gjyqtarët të cilët kanë më pak se 7 vjet përvojë profesionale deri në datën 01.01.2020 dhe që nuk kanë asnjë vlerësim;

d) të gjithë gjyqtarët e tjerë që mbeten nga lista e përgjithshme.